

AKTI I THEMELIMIT

TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Lëndina e Qershive”

Sot më datë 06.03.2021, Ortaku i vetëm themelues:

Znj. Sajmira Kaloti e bija e Qani Kaloti – t, e lindur në Uruçaj, Elbasan, më 13.03.1987, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pasaportë me nr. Personal I75313054F.

Ortaku, si më sipër e identifikuar, deklaron se ka vendosur të themelojë shoqërinë “**Lëndina e Qershive**” Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi si vijon.

**Neni 1
Emërtimi**

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**Lëndina e Qershive**” sh.p.k.

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka për objekt:

Shërbime në fushën e agroturizmit, restorante, hoteleri, agjensi udhëtimi, sporte ujore, lundrime turistike, stacione plazhi etj. Menaxhim hoteleri – turizëm, prodhim agrobujqësore, prodhime artizanale guri, zaire etj. Import-eksport i mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industriale si dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i tyre. Prodhime inerte prej betoni dhe tregtimi tyre. Bar kafe. Veprimitari në fushën e investimit, investitor, investime strategjike. Veprimitari në fushën e transportit, magaznimit, përpunimit, prodhimit e tregtimit me shumicë e pakicë, import e eksport, brenda e jashtë vendit i mallrave të të gjitha llojeve, ushqimore e industrial, prodhime bujqësore e blegtorale, fruta-perime e piye freskuese e alkoolike, materiale e lënde ndërtimi, pajisje e makineri, elektroshtëpiake, hidrosanitare, elektrike e hidraulike, dyqane reklamash etj. Mensa, përgatitja e ushqimeve, bar - restoran, shërbime hotelerie. Ndërtimi objekteve civile dhe industriale, turistike, bujqësore, serave, zyrave, rrugëve, hekurudhave, portave, aeroporteve, veprave energjitike, kanalizimeve dhe cdo vepre tjetër me qëllim ndërtimi. Restaurimi dhe riparimi i godinave dhe objekteve të ndryshme civile. Punime rrugësh, kanalizimeve, ujësjellësa, urash e veprash arti. Tregtimin me pakicë dhe shumicë e nafteës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikante, karburanteve, lëndëve djegëse. Dhënie me qira të apartamenteve e ambjenteve të shërbimit, dhënie me qira të mjeteve të transportit dhe transport për të tretë. Autolarje, autovetura, kamione, interior etj. Punime dhei e transport, punime murature, betoni, beton armeje, kontruksione te ndryshme metalike e druri. Punime rrugësh, kanalizimeve, ujësjellësa, urash e veprash arti.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën pronësia në adresën: "Nr pasurie 796, Zona kadastrale 1909, Lagjia Celam, Gurrë e vogël, Klos – Shqipëri"

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësie dhe të krijojë filiale në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin pa afat. Asamblea Ortakëve me vendim mund të vendlösë një afat për kohëzgjatjen e Shoqërisë.

Neni 5

Kapitali

5.1 Kapitali i shoqërisë tregtare private "**Lëndina e Qershive**" Sh.p.k., do të jetë 1.000 Lekë (një mijë). Kapitali në para është nënshkruar nga ortakët themelues si vijon:

Znj. Sajmira Kaloti, zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1.000 (një mijë) Lekë që përbën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme/ të drejta).

5.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Administrimi

6.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm i emëruar nga Asambleja e Ortakëve.

Administratori i Shoqërisë është: **Znj. Sajmira Kaloti e bija e Qani Kaloti – t, e lindur në Uruçaj, Elbasan, më 13.03.1987, madhore dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pashaportë me nr. Personal I75313054F.**

Administratori emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje për pesë vjet të tjera në rast se Asambleja e ortakëve nuk vendos ndryshe dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Administratori ka tagra të **pakufizuara**. Me titull thjeshtues, por jo gjithëpërfshirës, në mënyrë të veçantë ushtron këto tagra:

- administron Shoqërinë në zbatim të politikave tregtare të përcaktuara nga asambleja e ortakëve;
- përfaqëson shoqërinë;
- emëron përfaqësues të përgjithshëm ose të posaçëm për çështje të veçanta dhe vendos mbi shkarkimin e tyre;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, raportin mbi ecurinë e veprimtarisë dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet në Asamblenë e Ortakëve për miratim;
- kryen regjistrimet e detyrueshme të parashikuara nga regjistri tregtar;
- informon Asamblenë e Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- pranimet në punë, pagat, largimet nga puna, masat disiplinore për vartësit, miratimin e kërkesave për largim nga puna;
- të emërojë financierë e konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare, tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore për aktivitetin e kryer nga shoqëria;
- të lidhi marrëveshje me të tretë në kufijtë e objektit të aktivitetit të shoqërisë dhe të kompetencave të percaktuara nga ortakët;
- të shpérblehet për punën që kryen sipas marrëveshjes me ortakët themelues.
- të thërrasi asamblenë e përgjithshme, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj;
- të kryejë veprime/transaksionë në llogaritë rrjedhëse të shoqërisë me vlera të pakufizuara, përfshirë nënshkrimin e kontratave me të tretë.

6.2 Administrimi i shoqërisë me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të bëhet dhe nga një ose me shumë administratorë të cilët mund ta administrojnë së bashku ose veçmas shoqërinë sipas vendimit përkatës të asamblesë.

6.3 Administratori shkarkohet nga detyra nga asambleja e ortakëve në rastet si më poshtë:

- shkarkohet nga asambleja për shkak se nuk përbush detyrat që i janë caktuar nga statuti dhe ligji, bën mungesa të pajustifikuara për më shumë se tre muaj ose nuk eshtë më i aftë per t'i përbushur ato;
- jep dorëheqjen dhe ia komunikon atë Asamblesë, jo më vonë se 30 ditë para datës së largimit.

Neni 7 Viti Financiar dhe Bilanci

7.1 Viti Financiar fillon me 1 janar dhe mbyllte me 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimi përvitin e themelimit të Shoqërisë, viti finanicar fillon nga data e themelimit deri më 31 Dhjetor 2021.

7.2 Në rast prishje dhe likujdimi të Shoqërisë, në çdo moment dhe për çdo arsy, emërimi i likuidatorit do të miratohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 8

Dispozitat e fundit

Ky akt-themelimi i shoqërisë "Lëndina e Qershive" sh.p.k., u hartua në bazë të vullnetit të lirë të themeluesit, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i ndryshuar, dhe u hartua në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me të njejtën vlerë secila, me përjashtim në rast interpretimi, dhe u nënshkruan rregullisht nga ortakët e saj.

**Ortaku i Vetëm themelues
Sajmira Kaloti**

Sajmira Kaloti
